



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:119671
Datë: 13.09.2024
Numri i dokumentit: 06160857

Ac.nr.2000/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Ardian Ajvazi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: B. B., T. B., Afrim B. dhe R.B. të gjithë nga fshati R., Komuna e P., të cilët i përfaqëson I. I., avokat në P., sipas autorizimit, kundër të paditurit S. (M.) B. nga f. R., Komuna e P., të cilin e përfaqëson F. A. avokat në P., sipas autorizimit, për pengim posedim, duke vendosur sipas ankesës së autorizuarit të paditurit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.629/18, i datës 11.01.2021, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 30.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e autorizuarit të paditurit: S. (M.) B. nga fshati R., Komuna e P., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.629/18, i datës 11.01.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar C.nr.629/18, të datës 11.01.2021, të korigjuar me aktvendimin e datës 16.02.2021, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur të aprovet si e bazuar kërkesëpadia e paditësve B. B., T. B., A. B. dhe R. B. të gjithë nga fsh. R., Komuna e P. dhe Vërtetohet se i padituri S. (M.) B. nga fsh. R., Komuna e P., ka kryer aktin e pengim posedimit me datë 01.11.2016, ndaj paditësve B. B., T. B., A.B. dhe R.B., në mënyrë, duke e hapur, gropuar mihur themelin se kanalit të hapur nga pika 1. në anën Veri- Lindore në drejtim të pikës 2. është në gjatësi 10.62 m, në të cilën anë shihen rrënimet e themeleve, në gjerësi prej 0.45 m dhe thellësi prej 0.50 m, nga pika 2. deri në pikën 3. në gjatësi prej 8.03 m dhe nga

pika 3. në gjatësi prej 16.55 m deri në pikën 4., ana perëndimore, shihen gjurmë të themeleve të cilat janë mbuluara me zhavorr, në anën jugore nga pika 4. në gjatësi prej 8.47m, nga pika 5. kthehet në drejtim të Veriut deri në pikën 6. në gjatësi prej 8.10 m, nga pika 6 deri në pikën 7. në gjatësi prej 9.23 m, nga pika 7. gjer në pikën 8. në gjatësi prej 12.65 m, nga pika 8 kthehet në pikën 9 në gjatësi prej 11.02 m, në mënyrë Arbitrare dhe të Kundërligjshme, II. Detyrohet i padituri S. (M.) B. që ti i mbyllë në tërësi themelet e hapura dhe të largoj materialin ndërtimor duke kthyer këtë pjesë të ngastrës në gjendje që ishte para ndërmarrjes së veprimeve për rrethim dhe që në të ardhmen të përmbahet dhe të mos pengoi paditësit në shfrytëzimin e lirë të pronës së përbashkët ashtu si e kanë shfrytëzuar që një shekull që është pjesë e ngastrës Radavc, plani katastral nr. ... R. ma detajisht të përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të këtij Aktvendimi, në afat prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktvendimi nën kërcënim të përmbarimit, III. Obligohet i padituri S.(M.) B. që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 2 .520,00 €, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi i autorizuari i të paditurit në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktvendimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit këtë ankesë ta aprovoj në tërësi si të bazuar, aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë ta anuloj dhe lëndën t'ia kthej të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje ose ta ndryshoj aktvendimin e atakuar si dhe shpenzimet e procedurës, duke e refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e autorizuarit të paditurit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, me datën 14.11.2016, kanë paraqitur padi, kundër të paditurit, për pengim posedim, me propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, ku në precizimin e padisë kanë kërkuar që në bazë të matjeve të përcaktuara nga eksperti vërtetohet se kanali i hapur nga pika I në anën Veri- Lindore në drejtim të pikës II është në gjatësi 10.62 m, në të cilën anë shihen rrënimet e themeleve, në gjerësi prej 0.45m dhe thellësi prej 0.50m, nga pika II deri në pikën III në gjatësi prej 8.03m dhe nga pika III në gjatësi prej 16.55m deri në pikën IV, ana Perëndimore, shihen gjurmë të themeleve të cilat janë mbuluara me zhavorr. Në anën Jugore nga pika IV në gjatësi prej 8.47 m. Nga pika V kthehet në drejtim të Veriut deri në pikën VI në gjatësi prej 8.10 m. Nga pika VI deri në pikën VII në gjatësi prej 9.23m..., e në tërësi si në raportin e ekspertit gjeodet, në bazë të provave të administruara dhe posaçërisht në bazë të plotësimit të ekspertizës dhe mos deklarimit lidhur me precizimin e kërkesëpadisë mendon se në tërësi u vërtetua çështja dhe u argumentua e njëjta, se i padituri S.B. nga fshati R. Komuna P., ka kryer aktin e pengimit të posedimit në pjesën e ngastrës kadastrale me numër R., ku posaçërisht në pjesën perëndimore dhe jugore të saj, ashtu siç ka konstatuar edhe eksperti i

gjeodezisë në vend, në mënyrë arbitrare ka hapur themelet në dimensionet e precizuara më lartë dhe gjatësinë e precizuar nga ana e ekspertit për të ndërtuar murin me të cilin në mënyrë arbitrare ka penguar poseduesit e kësaj ngastre këtu paditësit B, B., T.B., A, B, dhe R, B. që të gjithë nga fshati R. Komuna P. , që si posedues të mullirit të ashtuquajtur M. i B. dhe pjesës së ngastrës kontestuese si oborr (parking i mullirit) duke e kryer veprimin e posedimit me datën 01.11.2016 deri në ndërprerjen e punimeve nga ana e Inspektoratit të Komunës së P. . Gjykatës, i propozon që të aprovoj në tërësi si të bazuar padinë, të detyrojë të paditurin S. B. që gjendjen e krijuar me veprimet e tij ta kthejë në gjendjen para veprimeve të tij, pra të mbyllë themelet e hapura, largojë materialin ndërtimor duke e kthyer në tërësi pjesën e ngastrës në gjendjen që ishte para ndërmarrjes së veprimeve për rrethim dhe po ashtu të përmbahet nga ndërmarrja e veprimeve të tilla në të ardhmen. Të detyroj të paditurin që menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi të kompensojë shpenzimet procedurale dhe gjyqësore të aprovuara më parë duke shtuar të njëjtës edhe vlerën prej 800 euro për dy seanca të mbajtura pas kthimit të lëndës në ri shqyrtim.

Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, duke vepruar sipas padisë së paditësve, me aktvendimin C.nr. 1026/16 të datës 27.06.2017, ka vendosur që të Apropohet kërkesëpadia e paditësve B. B., T. B., A. B. dhe R. B. të gjithë nga fshati R., Komuna e P. si e bazuar, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur sipas ankesës së autorizuarit të paditurit me aktvendimin Ac.nr.3890/17 i datës 16.02.2018, ka vendosur që të: Apropohet si e bazuar ankesa e të paditurit S. B. nga fshati R., Komuna e P. , Priset aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1026/16 i datës 27.06.2017 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje, me vërejtje dhe sugjerime si në aktvendim.

Gjykata e shkallës së parë, në rishqyrtim ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, ku pas shqyrtimit të provave dhe të gjitha shkrësave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar, C.nr.629/18 i datës 11.01.2021, me të cilin ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin korrigjues C.nr. 629/18 i datës 16.02.2021, ka vendosur që të: Korrigjohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr. 629/18 i datës 11.01.2021, në pikën II, të dispozitivit të aktvendimit të lartcekur ashtu që në vend të duke kthyer këtë pjesë të ngastrës në gjendje që ishte para ndërmarrjes së veprimeve për rrethim si dhe në arsyetimin e aktvendimit të lartcekur lidhur me shpenzimet e procedurës, në faqen e pestë, rreshti i fundit në vend të pala paditëse e ka humbur kontestin në tërësi, duke të shënohet pala paditëse e ka fituar kontestin në tërësi, II. Pjesa tjetër e këtij aktvendimi mbetet i pandryshuar, III. Ky aktvendim është pjesë përbërëse e aktvendimit C.nr. 629/18 i datës 11.01.2021.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka parashtruar se në kuptim të nenit 8 të LPK-së ka bërë vlerësimin e provave të administruara, ndërsa duke iu përmbajtur Aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë Ac. nr. 3890/17 të datës 16.02.2018, ka vlerësuar

faktet vendimtare për të konstatuar nëse mbrojtja gjyqësore është kërkuar brenda afatit ligjor. Nga provat e administruara, deklaratimet e palëve ndërgjyqëse, gjykata ka vërtetuar se padia e paditësve është paraqitur brenda afatit ligjor prej 30 ditëve. Këtë fakt gjykata e vërtetoi nga deklarimi i të autorizuarit të paditësve i cili në shqyrtimin kryesor të datës 11.01.2021, saktë ka precizuar se me datë 01.11.2016, është kryer akti i pengim posedimit nga i padituri, këtë rrethanë e argumenton me faktin se edhe në referatin e kërkesëpadiisë ka potencuar se pengim posedimi ka ndodhur 10 ditë para përpilimit të padisë, dt. 11.11.2016, të dorëzuar në gjykatë me datë 14.11.2016, të cilën rrethanë nuk e kundërshtoi i autorizuari i të paditurit. Kjo është vërtetuar edhe nga prova materiale që gjendet në shkresat e lëndës, njoftimi i Komunës së Pejës për inspektion, që për inspektim ka vepruar sipas kërkesës së datës 05.11.2016. Gjykata ka konstatuar se pjesa e ngastrës kontestuese, më detajisht e përshkruar si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, me marrëveshjen e paraardhësve të paditësve për 100 vite rresht në terren është shfrytëzuar nga klientët e mullirit (si vend për vendosjen e kafshëve që shërbenin për bartjen e të korrave, bluarjen e grurit dhe misrit). Këtë gjendje gjykata e vërtetoi nga dëshmitarët e proceduar në shqyrtimin kryesor të datës 01.06.2017. Po ashtu nga dëshmitarët e proceduar u vërtetua se fillimisht posedimin e fundit të ngastrës më detajisht të përshkruar si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, konkretisht ku është kryer akti pengim posedimi, e kanë pasur paraardhësit e paditësve ndërsa tani paditësit janë posedues të pjesës së ngastrës kontestuese, për çka vërtetohet legjitimiteti aktiv i paditësve. Nga arsyet e parashtruara ka vlerësuar se në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPDTS-së, kërkesëpadia është e themeltë, nga e cila bazë ligjore vendosi lidhur me çështjen kryesore, ndërsa vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore e ka mbështetur në nenin 452 paragraf 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes pajtohet me pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, pasi që përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk përfshihet në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe, në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndron pretendimi ankimor i palës së paditur se aktvendimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 al.2, pika n), pasi aktvendimi nuk është i përfshirë me të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë, dispozitivi i aktvendimit është i qartë dhe i përmbarueshëm.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar apo jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, për arsye se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha faktet vendimtare të çështjes që kanë të bëjnë me aktin e kryerjes së pengimit, vendin dhe kohën ku është kryer pengimi dhe mënyrën se si është manifestuar pengimi në posedim. Gjithashtu gjykata ka konstatuar se pushtetin faktik në paluajtshmërinë lëndore e kishte pala paditëse, e cila brenda afatit ligjor, përmes padisë konkrete ka kërkuar edhe mbrojtjen gjyqësore, e që në rastin konkret, kërkesa nga padia ka rezultuar të jetë e themeltë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se:

Me nenin 103, të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, përcaktohet se: “personi i cili e ushtron pushtetin faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë”.

Me nenin 104, të këtij ligji, përcaktohet se: “posedimi në një send fitohet me krijimin e pushtetit faktik mbi sendin...”.

Me nenin 107, paragraf 1, të këtij ligji përcaktohet se: “posedimi shuhet kur poseduesi heq dorë nga pushteti faktik mbi sendin ose në ndonjë mënyrë e humbë pushtetin faktik”, ndërsa me paragrafin 2, të këtij neni përcaktohet se: “posedimi nuk shuhet si rezultat i moslejimit të poseduesit për ushtrimin e kontrollit mbi sendin në një kohë të përkohshme”.

Me nenin 111, paragraf 1, të këtij ligji përcaktohet se: “personi i cili e privon nga posedimi poseduesin ose e pengon në posedim kundër vullnetit të poseduesit, vepron kundërligjshëm, përveç nëse privimi ose pengimi lejohet shprehimisht me ligj”, ndërsa me paragrafin 2, të këtij neni përcaktohet se: “posedimi i fituar si rezultat i pengimit të kundërligjshëm është me të metë. Pasardhësi i posedimit të tillë duhet të pranoj të metën e posedimit nëse ai ishte në dijeni për të metën apo ai është trashëgimtar i poseduesit”.

Me nenin 113 paragraf 1, të këtij ligji përcaktohet se: “Nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundër ligjshme, poseduesi mund të kërkoj rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës, i cili me raport me poseduesin është në posedim me të meta”, me paragrafin 2, të këtij neni përcaktohet se “nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi mund të kërkoj nga poseduesi mënjanimin e pengesave, nëse priten pengime në të ardhmen të kërkoj mbrojtje gjyqësore”, ndërsa me paragrafin 3, të këtij neni, përcaktohet se: “kërkesa kundër ndërhyrjes në posedim është përjashtuar në qoftë se poseduesi e ka posedimin me të meta në raport me penguesin ose të drejtën e paraardhësit të penguesit”.

Me nenin 114 të këtij ligji, përcaktohet se “Kërkesa mund të parashtrohet vetëm në afat prej 30 ditësh, pasi që poseduesi e merr në dijeni lidhur me privimin ose pengimin e posedimit të tij. Kërkesa shuhet pas kalimit të një viti nga privimi ose pengimi i posedimit”.

Me nenin 480 të Ligjit për Procedurën Kontestimore - LPK-së, përcaktohet se: “Shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengim posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë, përjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë dhe pandërgjegjshmërinë e posedimit ...”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit e ka pranuar përfundimin e gjykimit të shkallës së parë për aprovimin e kërkesëpadisë së paditësve, për arsye se nga provat e administruara, përkatësisht nga deklarimet e palëve ndërgjyqëse dhe dëshmitarëve në seancat gjyqësore, është vërtetuar se i padituri S.B. ka kryer aktin e pengim posedimit konkretisht me datën 01.11.2016, ashtu që ka grupuar themelin për të ndërtimin e murit dhe gjatë tërë hapjes së themelit ka grumbulluar materialin për fillimin e ndërtimit të murit për të rrethuar pjesën kontestuese të ngastrës, ku paditësit e kishin pasur posedimin e fundit faktik në atë ngastër. Andaj

në këtë rast, gjykata drejtë ka vërtetuar se pushtetin faktik mbi sendin e paluajtshëm që është objekt i kërkesëpadisë, e kanë pasur paditësit dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me pengim posedim, prandaj edhe është detyruar i padituri që ta kthej gjendjen e mëparshme të posedimit.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për arsye se në këtë rast gjykata e shkallës së parë, kërkesën e paditësve e ka shqyrtuar në kuadër të autorizimeve që përcaktohet në kuptim të dispozitave të lartcekura, në konstatimin fakteve të gjendjes së fundit të posedimit, kohën kur ka ndodhur akti i pengimit dhe të pengimit të bërë dhe pas administrimit të provave ka ardhur në përfundim se pretendimet e të paditurit janë të pabazuara.

Në procedurën e pengimit të posedimit janë të parëndësishme dhe nuk mund të shqyrtohen pretendimet lidhur me pronësinë apo kompensimin e dëmit sepse për çështjet e tilla mund të iniciohen procedura tjera dhe se çfarëdo vendimi i dhënë në procedurën e pengimit të posedimit, qoftë refuzues apo aprovues, siç është vendosur në këtë rast, nuk ka asnjë ndikim në asnjë procedurë tjetër dhe për asnjë çështje tjetër që mund të jetë në zhvillim ose që do të mund të iniciohet në mes të palëve të njëjta ndërgjyqësulidhur me ndonjë kërkesë të caktuar, e veçmas atyre që lidhen me të drejtën e pronës apo kompensimin e dëmit.

Gjykata i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore, por nuk ka gjetur se ekzistojnë rrethana apo shkelje të tilla që do të ndikonin për nxjerrjen e një vendimi ndryshe, për çka edhe vendosi si dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e parashtruara si më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195, 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2000/21, me datë 30.08.2024

Kryetare e kolegjit

Hunaida Pasuli